



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

---

Nr. 36 Prot

Tiranë, më 30.03.2009

**VENDIM Nr. 1 dt. 27.03.2009**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 27.03.2009, pasi rishqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe

**VENDOSI:**

**Sipas pikave të rendit të ditës:**

**I. Për diskutimin e temave:**

1. **Miratohet:** Studim-ekspertizë, për Gjirokastrën (studimi i Prof. Dr. Emin Riza dhe Z. Genc Samimi për shtëpitë e rrezikuara dhe disa konkluzione për mënyrën e ndërhyrjes e faturën financiare. Pas sigurimit të fondeve do të ngrihet grupi i punës për hartimin e projekteve të restaurimit të këtyre banesave).
2. **Miratohet:** Problematika me sinjalistikën turistike 2008, të vendosur në Gjirokastrë (emrat e tabelave me emërtime të konfirmuara. U miratua lista bashkangjitur me ndryshimet përkatëse).
3. **Miratohet në parim:** “Studim për brigadat e mirëmbajtjes dhe mjeshtrit e punës pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare” (studimi i Prof. Dr. Valter Shtylla për organizimin e mjeshtrave pranë DRKK-ve. Të studiohet materiali dhe të argumentohet. Të bashkëpunohet me Drejtorinë juridike të MTKRS për të kaluar në detaje).
4. **U vendos të shqyrtohet nga Drejtoria Juridike e MTKRS dhe të diskutohet në mbledhjen e radhës** rregullorja e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (rregullorja ekzistuese dhe ajo me ndryshime bashkëlidhur).

## II. Të miratojë projektet e restaurimit të financuara nga buxheti i shtetit:

1. Projekti i restaurimit të kullës së Sahatit të xhamisë së Et'hem Beut, Tiranë.  
**Miratohet: Projekti i restaurimit të kullës së Sahatit;**  
**Përsa i përket shtesës së volumit të objektit ekzistues mbrapa kullës së Sahatit që projekti parashikon të kthehet në muze si dhe pjesës që projekti parashikon të shtrohet me kalldrëm dhe gjelbërim para kullës së Sahatit, u vendos të zhvillohet një konsultë me përfaqësues të Bashkisë.**
2. **Miratohet** paketa e projekteve të mirëmbajtjes të qendrës historike Gjirokastër. (relacion, preventiv).
3. **Miratohet** projekt restaurimi kulla Elmaz Dëzhgiu, Guri i Bardhë, Mat. (Të shihen mundësitë për të nxjerrë edhe një fond shtesë prej 500 000 lekë, me qëllim realizimin 100%, të projektit. Në rast të kundërt do të shikohet mundësia e rialokimit të fondit)
4. **Miratohet me shumicë votash**, projekt restaurim, mure-porta-fasada, lagja Kala, në Q. Historike, Berat. (ka një projekt gati prej 1/3 e shumës prej 12 milionë). Po punohet për përgatitjen e 2/3 tjetër.
5. **Miratohet me shumicë votash** projekt restaurim, mure-porta-fasada, lagja Goricë, Berat (projekti gati 10.4 milionë, po punohet për një shtesë prej 1.6 milionë me qëllim kompletimin e tij).
6. **Miratohet** projekt restaurimi i shtëpive të djegura në lagjen kala, Berat. (shtëpi të djegura, shumë pranë itinerarit kryesor të lëvizjes që turistëve) totali rreth 6 milionë
  - Liri Kote
  - Kristaq Kote
  - Koçi Plaku
7. **Miratohet** projekti i restaurimit Kalaja e Durrësit.
8. **Miratohet** projekt restaurim të fasadave “Pazari Korçë”, Korçë.
9. **Miratohet** projekt restaurim, i banesës së piktorit Vangjush Mio, Korçë.
10. **Miratohet** paketa e projekteve të restaurimit të ikonave të Muzeut Historik Kombëtar:
  - Ikona Deizis
  - Ikona Shën Thanasi
  - Ikona Porta të bukura
11. **Miratohet** projekti punime restauruese në Manastirin e Apolonisë. (dysHEMEJA).  
**Projekti miratohet me vërejtjen: Manastiri të ketë dy dyer funksionale, 3 dyer jo funksionale të murosura të dukshme nga jashtë me veshje dekorative, por jo nga brenda.**

### III. Të miratojë projektet e restaurimit të cilat janë të financuara nga donatorë privatë ose presin financim

1. **Miratohet** projekt restaurimi dhe kthim në muze i Burgut të Spaçit.
2. **Miratohet** projekti shkencor i restaurimit të mozaikut të Sarandës në PTT Sarandë, (financuar nga Universiteti i Bolonjës). Zbatimi i projektit do të fillojë vetëm pas firmosjes së marrëveshjes nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Sarandë, Drejtoria e Kulturës Kombëtare, dhe Universiteti i Bolonjës.

### IV. Nuk u miratuan dhe u vendos të diskutohen në mbledhjet e ardhshme:

1. Preventiv pjesor i Manastirit të Mesopotamit, projekti miratuar me vendim nr. 8, dt 08.04.2008, vazhdim punimesh). **(Të diskutohet në mbledhjen e ardhshme, në të cilën duhet të paraqiten projekti me preventivin bashkangjitur).**
2. Propozimi i DRKK Berat për Projekt-idene mbi restaurimin e fasadave te ansambllit te banesave te lagjes Mangalem. Jane te pakten 34 banesa që do trajtohen, me mundesi qe numri i tyre të shkojë 50. Fondit prej 12 milionë lekësh mund ti shtohet dhe fondi prej 14 milionë lekësh (kalldrëme/ura e Goricës) dhe projekti të përfshijë gjithë Mangalemin si dhe ndriçimin profesional të lagjes). **Të diskutohet në mbledhjen e Këshillit Shkencor të IMK, projekti i plotë.**
3. Projekt idenë e rikonceptimit tërësor të mozaikut të Tiranës.
4. Kërkesë për rikonstuksion banese tre katëshe, Vila Dabërdaku, Shkodër (Arkitekt Pirro Thomo, Artan Shkreli). **(Të shikohet ana ligjore)**
5. Kërkesë për rikonstuksion banese me pronar Durim Nepravishtën, zona tampon, Berat (verifikuar në vend sipas porosisë së lënë në KKR, hartuan projektin Genc Samimi, Dritan Çoku). **(Të shikohet ana ligjore)**

### V. Nuk u diskutuan

#### A) Projektet e mëposhtme

1. Projekti i konservimit të muraturës dhe rrethimi me punime dheu në bazilikën e Shën Janit, Delvinë, Sarandë.
2. Projekt restaurimi i ndërhyrjes konservuese dhe restauruese në Gimnazin (termat) pranë bazilikës C, Bylis.
3. Projekt restaurimi i fazës së parë në sterën publike Bylis.
4. Projekt restaurimi i murit perëndimor në vazhdim nga viti 2007, Bylis.
5. Projekt kons. dhe rest. i pikturës murale të bemës në katedralen e Shën Mërisë – pjesë integrale e Muzeut “Onufri”, Berat.
6. Konservimi dhe restaurimi i pikturës murale të kishës së Shën Kollit, Kala, Berat.

**B) Kërkesa për licensë:**

1. Kërkesë e arkitektes Lida Miraj, për pajisjen me licensë profesionale personale për kategorinë A, “Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”.

**C) Kërkesa për rijetëzime monumentesh kulture**

- Kalaja e Kaninës, Vlorë,

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
ARDIAN TURKU**



**SEKRETAR I KKR  
PROF. DR. VALTER SHTYLLA**

